

## Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 "Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve".

Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkuftar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja ëeb e projektit: [www.adriaticpacbc.org](http://www.adriaticpacbc.org)

### PËRMBLEDHJE

1. Dalja masive në plazhe e breshkave detare të ngordhura në brigjet e Adriatikut Verior.
2. Antarët e parë të Rrjetit të Qyteteve NETCET.
3. Një vend folezimi i breshkave detare në brigjet italiane të Adriatikut.
4. Qendrat NETCET të shpëtimit të breshkave detare dhe cetaceve.
5. Vëzhgimi me foto-identifikim i cetaceve në Malin e Zi.

## 1. Dalja masive në plazhe e breshkave detare të ngordhura në brigjet e Adriatikut Verior



WWF-Area Marina Protetta di Miramare (F. Zuppa)

Në periudhën Tetor – Dhjetor 2013, dalja masive e breshkave detare të ngordhura në brigjet e Adriatikut Verior ka shënuar një ngjarje pa precedentë. Gjithsej u gjetën 286 breshka (nga të cilat vetëm 1 individ i gjallë), në vende dhe ditë të ndryshme. Mund të përcaktohen 4 grupime breshkash të dala në breg, ndoshta të lidhura me drejtimin e erës dhe rrymave detare:

65 individë në periudhën 1 Tetor – 2 Nëntor, në jug të Lumit Po (44°42'00"N 12°11'00"E);

36 individë në periudhën 1 Tetor – 11 Nëntor, në Grado (45°41'00"N 13°24'00"E);

166 individë në periudhën 7 Nëntor – fund Dhjetori, në bregdetin e Riminit (44°03'00"N 12°34'00"E);

39 individë në periudhën 12 Nëntor – fillim Dhjetori në bregdetin e Ankonës (43°37'00"N 13°31'00"E).

Në pjesët e tjera të Adriatikut nuk janë shënuar dalje të ngjashme breshkash në breg, siç raportohet për brigjet lindore të Adriatikut nga Blue World, MEC dhe SINP për Kroacinë dhe Universiteti i Primorskës për Slloveninë si dhe për brigjet jugore të Adriatikut, raportuar nga APAWA dhe HAS për Shqipërinë dhe Universiteti i Barit për Italinë e Jugut.

Fondacioni Cetacea dhe WWF – Zona e Mbrojtur Detare e Miramares ndërmorën menjëherë një bashkëpunim me ASL dhe IZS (dy agjenci të Ministrisë së Shëndetësisë së Italisë) në zonat e tyre, përkatësisht në Emilia Romagna dhe Friuli Venezia Giulia. Ato gjithashtu bashkëpunuan me universitetet e Padovës dhe Bolonjës për kryerjen e analizave të nekropsisë.

Aspektet biologjike të lidhura me këtë ngjarje janë studiuar nga Muzeu i Historisë së Natyrës në Venecia dhe Instituti Oqeanografik i Triestes, i cili gjithashtu është duke analizuar lidhjet mes rrymave detare, erës dhe daljeve të breshkave në secilën periudhë, në bashkëpunim edhe me ARSO (Agjencia Sllovene e Mjedisit).

Analizat nekropsike zbuluan plagë në shumicën e individëve të gjetur. Me përjashtim të individëve të ngecur aksidentalisht në rrjeta, në individët e tjerë ishin të zakonshme plagët inflamatore të zorrëve (enterit hemoragjik kataral i theksuar) dhe plagët edematoze-hemoragjike multifokale në muskujt e gjoksit dhe në anën barkore të qafës. Këto plagë janë të lidhura me ndryshimin e theksuar të përshkueshmërisë së enëve të gjakut, gjë që çon në rrjedhje të gjakut dhe / ose lëngjeve të tjera të trupit, siç është vërejtur në disa infeksione bakteriale, virale, myqesh ose në disa intoksikime. Meqenëse gjatësia e karapaksit luhatej nga 20 në 115 cm, hipoteza fillestare sipas së cilës ngordhja lidhej me ndonjë ushqim i la vendin një dyshimi më të mundshëm për praninë e ndonjë substance kimike, ose biologjike (ndoshta algë) në ujë në disa prej zonave bregdetare. Ky mendim mbështetej edhe nga fakti se mënyrat e

dekompozimit të zhguallit të breshkave ishin pothuajse të njëjta në secilin nga 4 grupet e përmendura më sipër. Meqenëse nuk ka patur diferenca të rëndësishme në parametrat oqeanografik kryesorë mes zonave të basenit të Adriatikut, siç referohet nga ARPA (Agjencia Rajonale e Mbrojtjes së Mjedisit), as në periudhën në fjalë, por as në periudhat e mëparshme, përveçse një vonesë e vogël në uljen e temperaturës së ujit në Tetor në Gjirin e Triestes, mund të ngrihet hipoteza se punimet gjeologjike të zhvilluara në ujrat Kroate pak përpara fillimit të daljes së breshkave të ngordhura në brigje, mund të kenë nxitur breshkat të lëvizin, ndoshta duke u grumbulluar në zona të caktuara në det. Megjithatë, gjatë analizave nekropsike nuk u gjetën plagë të shkaktuara nga goditjet valore të atyre punimeve.

Fatkeqsisht, ndikimi afatgjatë i kësaj ngjarjeje në ekuilibrin e popullatës duket i rëndë: 49% e individëve të ngordhur ishin sub-adultë dhe 26% ishin adultë, gjë që pritet të ndikojë ndjeshëm në periudhat e ardhshme të riprodhimit.

Së fundmi, dy çështje të panjohura kërkojnë akoma zgjidhje. Në Universitetin e Padovës gjatë provave bakteriologjike të zorrëve të breshkave që iu nënshtruan analizës nekropsike, rezultoi sterilitet i plotë i organit në 50% të rasteve. Veç kësaj, në 7 nga 10 individët e gjetur në Grado gjatë analizave parazitologjike në feçe, u vërejtën struktura rrethore me gjatësi 7-10 µm. Fillimisht u mendua se këto mund të jenë alga toksike, të cilat mund të kenë shkaktuar ngordhjen, megjithatë, akoma po punohet për identifikimin e këtyre "trupthave".

Me shpresën për të dhënë një shpjegim për këto dy çështje të panjohura, shumë analiza të tjera janë në pritje për t'u bërë me kampionet e grumbulluara, si p.sh. ekzaminimi toksikologjik i mëlçisë për lëndë toksike me origjinë kimike dhe biologjike.

*Lisa Poppi – Universiteti i Padovës*

## **2. Antarët e parë të Rrjetit të Qyteteve NETCET: qytetet e Adriatikut së bashku për cetacetë dhe breshkat detare**

Një nga qëllimet kryesore të projektit NETCET është që të rrisë bashkëpunimin dhe të forcojë rrjetet mes qyteteve të përfshirë në mbrojtjen e breshkave detare dhe cetaceve në rajonin e Adriatikut. Rrjeti i Qyteteve NETCET, i parashikuar të ngrihet në kuadër të këtij projekti, synon të rrisë ndërgjegjen publike për rolin e këtyre qyteteve në mbrojtjen e breshkave detare dhe cetaceve. Duke u përfshirë në këtë rrjet, qytetet e Adriatikut marrin përsipër të informojnë

publikun mbi kërcënimet e këtyre llojeve të rrezikuara, si dhe mbi mundësitë e zvogëlimit të rreziqeve ndaj tyre.

Rrjeti i Qyteteve NETCET ka kënaqësinë të mirëpresë 4 qytete në këtë rrjet: Pula, Peskara, Numana dhe Kotorr.

**Pula (Kroaci)** ishte qyteti i parë që u antarësua



në Rrjetin e Qyteteve NETCET, pas nënshkrimit të Memorandimit të Mirkuptimit mes Kryetarit të Bashkisë së Pulës Boris Miletić dhe Nënkrëtarit të Bashkisë së Venecias për Mjedisin Gianfranco Bettin. Pula është qyteti më i madh i rajonit të Istrias, Kroaci, i vendosur në pjesën jugore të gadishullit të Istrias. Ky qytet ka traditë të hershme në ndërtimin e anijeve, turizëm, peshkim, por edhe në mbrojtjen e natyrës. Në sajë të Akuariumit të Pulës në Fort Verudela qyteti ofron ekspozita, aktivitete edukative dhe është i interesuar të vazhdojë promovimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi praninë dhe mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare.

Që prej vitit 2001 qyteti **Numana (Itali)**, në sajë të



Shërbimit të Mbrojtjes Civile, është duke zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm për ruajtjen dhe asistencën ndaj vertebrorëve të mëdhenj detarë, me fokus breshkat dhe cetacetë e Adriatikut. Në këtë përvojë, ishte e natyrshme që të nënshkruhej përfshirja e Numanës në Rrjetin e Qyteteve NETCET nga kryebashkiaku i saj Marzio Carletti. Aktivitetet e projektit përputhen mjaft mirë me aktivitetet e filluara kohë më parë nga Numana në nivelin e masave të drejtpërdrejta për mbrojtjen dhe ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare.

Gjatë Forumit XV të qyteteve të Adriatikut dhe Jonit, të zhvilluar në Brindisi në Dhjetor 2013,

drejtori i politikave evropiane në Bashkinë e Venecias prezantoi konceptin mbi Rrjetin e Qyteteve NETCET. Ky ishte një okazion për presidentin e Forumit, Luigi Albore Mascia, Kryebashkiak i **Peskarës (Itali)**, për të nënshkruar Memorandumin e Mirkuptimit për përfshirjen e këtij qyteti në Rrjet. Qytete të tjerë të përfaqësuar në forum shprehën dëshirën për t'u përfshirë në Rrjet dhe sigurisht janë të mirëpritur. Qyteti i Peskarës është i vendosur në një pozicion qendror në një zonë të gjerë të urbanizuar, e konsideruar si "zona metropolitane e Peskarës", e cila, me 125.000 banorët e saj, përfaqëson një zonë të rëndësishme zhvillimi për iniciativat e ndryshme në shkallë rajonale. Nëpërmjet Departamentit të Mbrojtjes së Kafshëve, Këshilli Bashkiak ka nxitur ndërgjegjësimin e publikut për



mbrojtjen e kafshëve, me qëllim për të ndihmuar bashkëjetesën mes njeriut dhe kafshëve, gjithashtu edhe për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Ky departament është përfshirë në mjaft iniciativa dhe aktivitete për mbrojtjen e ekosistemeve. Në vitin 2013 në zonën e Peskarës janë lëshuar në det mbi 50 breshka detare të kapura aksidentalisht në rrjetat e peshkimit.

Me 17 Janar 2014, Z. Tvrtko Crepulja, Nënkrëtar



i Bashkisë së **Kotorrit (Mali i Zi)**, nënshkroi Memorandumin e Mirkuptimit midis qytetit të Kotorrit dhe atij të Venecias për përfshirjen në Rrjetin e Qyteteve NETCET. Përfaqësues nga Instituti i Biologjisë Detare të Kotorrit paraqitën aktivitete të ndryshme të zhvilluara në kuadër të projektit NETCET, si dhe synime të projektit në pritje për t'u realizuar. Bashkia e Kotorrit do të

përfshihet në aktivitete ndërgjegjësuere dhe aktivitete të tjera të lidhura drejtpërdrejtë me zvogëlimin e kërcënimeve ndaj cetaceve dhe breshkave detare. Kotorri është një qytet bregdetar, i vendosur në Gjirin e Kotorrit, me popullsi 13,510 banorë. Gjatë viteve të fundit ai ka patur një rritje të vazhdueshme të numrit të turistëve, shumë prej të cilëve vijne me anije kroçierë.

Qytete të tjerë janë të mirpritur për t'u përfshirë në Rrjet dhe për të promovuar rolin e qyteteve të Adriatikut për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare.

Duke qenë pjesë e këtij rrjeti, qytet pjesëmarrëse do të kenë mundësi më të mëdha për të këmbyer informacion dhe publikuar aktivitetet e tyre mbi

cetacetë dhe breshkat detare në faqet e projektit NETCET, Bashkisë së Venecias dhe Forumit NETCET (<http://netcet.forumfree.it/>). Çdo qytet i interesuar mund të marrë pjesë në përpunimet e ardhëshme të strategjive të përbashkëta për ruajtjen e breshkave detare dhe cetaceve, të cilat do të paraqiten në konferencën përfundimtare të projektit në Venecia, në Korrik 2015, ku ato do të jenë të ftuar.

Për informacione më të detajuara mbi antarësimin në Rrjet, mund të vizitoni faqen e projektit, <http://www.netcet.eu/city-network> ose mund të komunikoni me e-mail me koordinatorët e projektit: [netcet@comune.venezia.it](mailto:netcet@comune.venezia.it)

**Carole Maignan – Bashkia e Venecias**

### 3. Një vend folezimi i breshkave detare në brigjet italiane të Adriatikut: një ngjarje e rrallë!

Folezimi i breshkës së zakonshme të detit *Caretta caretta* është një ngjarje e rrallë në brigjet italiane. Për këtë arsye, u konsiderua si surprizë dhe ngjarje e veçantë gjetja e një vendi folezimi në Roseto degli Abruzzi (Teramo), me 15 Shtator 2013. Kjo gjetje u bë nga Qendra e Studimit të Cetaceve (Shoqata Italiane e Studimit të Gjitareve dhe Zvarranikëve Detarë), e cila është duke bashkëpunuar me Bashkinë e Peskarës në kuadër të projektit NETCET, si dhe me WWF Abruzzo dhe Zonën e Mbrojtur Detare "Torre del Cerrano".



Një ditë përpara gjetjes së vendit të folezimit, një breshkë e vogël me gjatësi vetëm 7 cm u gjet rastësisht nga një grua që shëtiste në breg. Ajo menjëherë njoftoi Rrojtjen Bregdetare dhe breshka u strehua në "Spitalin e breshkave - Carmine Di Silvestro" pranë kapitenerisë së portit të Montesilvanos (Peskara), "spital" i menaxhuar nga Qendra e Studimit të Cetaceve. Në të njëjtën ditë 15 breshka të tjera të vogla dolën nga rëra dhe u drejtuan për në det, në prani të pushuesve në plazh, të cilët u surprizuan nga kjo ngjarje e rrallë. Pas këtyre ngjarjeve, vullnetarët e Qendrës së Studimit të Cetaceve, WWF Abruzzo dhe Zona e Mbrojtur Detare "Torre del Cerrano" filluan të monitorojnë zonën për 24 orë dhe arritën të gjejnë vendin e folezimit të breshkës. Brenda folesë u gjetën vezë dhe foleja u vëzhguar në mënyrë të vazhdueshme, ditën dhe natën, për të kontrolluar çeljen e tyre. Gjatë këtyre vëzhgimeve u bënë edhe matje të temperaturës brenda dhe jashtë folesë. Çelja e vezëve u bë gjatë një periudhe 10 ditore, kryesisht natën, në datat 15 deri 26 Shtator 2013 dhe mbi 20 breshka të çelura arritën të futen në det.

Kjo gjetje e vend folezimit të breshkës detare *C. caretta* është shumë e rëndësishme sepse është dokumentimi i parë i folezimit në këtë gjerësi gjeografike në brigjet italiane të Adriatikut. Një gjë e tillë gjithashtu tregon vlerat e plazheve të Adriatikut për riprodhimin dhe mbrojtjen këtij lloji, megjithë praninë e vazhdueshme të turistëve në plazh gjatë verës. Është për t'u theksuar çelja e vezëve në këtë plazh, pavarësisht ndikimit të madh të pushuesve gjatë ditës. Më 21 Shtator 2013 breshka e strehuar në Qendrën e Studimit të Cetaceve u lëshua në det, në prani të turistëve kureshtarë.

**Rosalia Montefusco – Bashkia e Peskarës**

## 4. Aktivitete në dy qendrat e para NETCET të shërimit të breshkave detare: Numana (Itali) dhe Lošinj (Kroaci)

### Reabilitimi i breshkave detare në Numana (IT)

Në Numana, Fondacioni Cetacea Onlus ka ndërtuar një qendër reabilitimi të breshkave detare përpara lëshimit të tyre në det, mbështetur financiarisht nga Projekti NETCET (Programi IPA Adriatic CBC) dhe në bashkëpunim me Rrjetin e Mbrojtjes së Breshkave Detare të Rajonit Marke, si dhe me Bashkinë e Numanës. Ky mjedis ka marrë emrin "Caletta delle Tartarughe" (Limani i Breshkave), siç e quajten banorët e Numanës.

Në këtë qendër trajtohen në vaska të posaçme breshkat e dëmtuara, të plagosura ose të sëmura, përpara



se të lëshohen në det. Këtu, pas reabilitimit, bëhet edhe një kontroll paraprak i aftësive të breshkave për të verifikuar nëse ato do të jenë të afta të përballojnë jetën në det pasi të lëshohen. Për këtë arsye kjo qendër u ndërtua në det, në një zonë pranë qytetit të Numanës, në një sipërfaqe 1224 m<sup>2</sup>, e rrethuar nga një rrjetë me gjatësi 114 m dhe lartësi 3.5 m. Me 21 Qershor 2013 këtu filloi një projekt eksperimental për të siguruar reabilitimin afatshkurtër (një deri në dy javë) të disa breshkave detare të cilat trajtoheshin në qendrën e Fondacionit Cetacea në Riccione.

Periodha e reabilitimit në det i ndihmon breshkat e strehuara që të aktivizohen më mirë se sa në vaskat e zakonshme, prandaj

konsiderohet si një mënyrë e mirë testimi për ri-aftësimin e tyre për jetën në det, gjë që është e një rëndësie themelore për të garantuar mbijetesën e tyre në kushte natyrore, përpara lëshimit.

Në këto kushte, është e mundur që të vlerësohen një sërë parametrash të sjelljes së breshkës që përcaktojnë gjendjen shëndetsore dhe shërimin e plotë të saj, me anë të analizimit të aftësisë për të notuar dhe për t'u zhvendosur normalisht në të gjithë kolonën ujore, qëndrimin në fund të detit dhe aftësisë për t'u ushqyer.

Gjatë vitit të parë, 5 individë u futën në zonën e reabilitimit, por vetëm për 3 prej tyre u grumbulluan të dhëna të mjaftueshme për analizën statistikore.

Breshkat e vendosura në zonën e para-lëshimit, u lanë në ujë për 12 orë në ditë (me përjashtim të ditëve me kushte të papërshtatshme të motit), nën vëzhgimin e specialistëve dhe vullnetarëve. Në këtë mënyrë u mblodhën të dhëna për kohëzgjatjen e zhytjes së breshkave dhe për sjelljen e tyre në një mjedis shumë të ngjashëm me mjedisin e tyre natyror.

Rezultatet ishin interesante, sepse u vërejt që kohëzgjatja dhe frekuenca e zhytjeve, si dhe lëvizja aktive, ishin më të larta se në rastet e reabilitimit në vaskat e zakonshme. Kjo konfirmon rëndësinë e metodës së provave të para-lëshimit për reabilitimin e breshkave detare.

Kjo zonë ka tërhequr vëmendjen e vizitorëve të shumtë në plazhin përballë saj, si turistë, ashtu edhe banorë të Numanës, ku gjithashtu janë ekspozuar edhe informacione mbi projektin NETCET dhe mbi breshkën e detit *Caretta caretta*. Suksesi i kësaj iniciative ka bërë që Bashkia e Numanës të marrë vendimin për promovimin e qytetit si "Numana, qyteti i breshkave" dhe për antarësimin në Rrjetin e Qyteteve NETCET.

Valeria Angelini - Fondacioni Cetacea Onlus

## Qendra e shërimit të breshkave në Mali Lošinj (HR)

Presidenti i Republikës së Kroacisë, Z. Ivo Josipović, mori pjesë në inaugurimin e Qendrës së Shërimit të Breshkave Detare në Mali Lošinj, me 19 Korrik 2013. Ngritja e kësaj qendre është bërë në bashkëpunim me Bashkinë e Mali Lošinj, Bordin e Turizmit të Mali Lošinj dhe Grupin Jadranka, të cilët mundësuan ndërtesën e qendrës në Hotel Vespera. Ndërtimet e brendshme dhe pajisjet e qendrës u mundësuan nga Projekti NETCET.

Në këtë qendër sigurohet e gjithë ndihma e nevojshme për breshkat detare të dëmtuara, plagosura apo të sëmura. Qendra përbëhet nga një dhomë operative me një vaskë të përkujdesjes intensive, një mjedis tjetër me tre vaska shërimit, i cili është i hapur për publikun, si dhe një mjedis informacioni për vizitorët. Pas shërimit breshkat lëshohen në det dhe disa prej tyre unazohen për monitorim. Unazimi bën të mundur gjurmimin e lëvizjeve të breshkave, vëzhgimin e ri-afhtësimit të tyre në det dhe sigurimin e të dhënave mbi biologjinë e këtyre zvarranikëve interesantë.

“Pacienti” i parë në këtë qendër ishte një breshkë e re femër e llojit *Caretta caretta*, e cila u quajt Sansego. Ajo u gjet duke plluskuar në sipërfaqe të detit pranë ishullit Susak (i cili në italisht quhet Sansego). Breshka u dërgua menjëherë në qendrën e shpëtimit, ku u ekzaminua nga veterineri i zonës. U konkludua se problemi i breshkës lidhej me grumbullimin e një sasive gazrash në zorrë, që mund të vijë si rezultat i reagimit ndaj



shqetësimeve. Veterineri sugjeroi qëndrimin e Sansegos nën vëzhgim për pak ditë. Megjithë qëndrimin e shkurtër në qendrën e shpëtimit, breshka tërhoqi shumë vizitorë, të cilët pyesnin çdo ditë për gjendjen shëndetësore të saj. Në fillim Sansego nuk shfaqte shumë interes për ushqimin e ofruar, por pas 3 ditësh ajo ishte e uritur dhe hante çdo gjë që i jepej. Pas 5 ditësh qëndrimi dhe shërimit në qendër, ajo u lëshua në det në plazhin Borik. Media tregoi mjaft interes për këtë ngjarje, ashtu sikurse edhe turistët e shumtë që u mbledhën në plazh për të parë lëshimin e breshkës në det.

Një rol tjetër i rëndësishëm i Qendrës së Shërimit të Breshkave Detare është edhe roli edukativ. Të gjitha llojet e breshkave detare janë të mbrojtura me ligj në Kroaci dhe janë përfshirë në Listën e Kuqe të IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës), si lloje të kërcënuara. Në këtë kontekst, misioni i kësaj qendre është të thjeshtojë të kuptuarin nga

publiku për rëndësinë e mbrojtjes dhe ruajtjes së breshkave detare. Në këtë qendër ka informacione të ndryshme, përfshirë edhe ato dixhitale, në dispozicion të vizitorëve. Bordi i edukimit jep informacione mbi biologjinë dhe anatominë e breshkave, si dhe kërcënimet ndaj tyre. Është e mundur të shihen edhe filmime të regjistruara gjatë punës me breshkat. Qendra ka një ekip biologësh dhe studentësh të gatshëm për të bërë më të mirën e mundëshme të tyre për t’iu përgjigjur vizitorëve. Gjithashtu, mund të vëzhgohen breshkat dhe në vaskat e shërimit, meqenëse paretet e vaskave janë transparente. Gjatë sezonit të parë pas hapjes së qendrës, ndonëse në një periudhë të shkurtër, qendra kishte 900 vizitorë dhe ky është vetëm fillimi i interesit të publikut për breshkat detare në këtë qendër.

*Paula Počanić – Instituti Blue World*

## 5. Vëzhgimi me foto-identifikim i cetaceve në Malin e Zi

Për herë të parë në Malin e Zi u zbatua vëzhgimi me foto-identifikim i cetaceve nga anija. Kjo u realizua në pranverë dhe verë të vitit 2013 në kuadër të projektit NETCET. Tre ekspertët nga Instituti i Biologjisë Detare, Kotorr, që morën pjesë në këtë vëzhgim janë trajnuar paraprakisht nga Instituti Blue World në Kroaci mbi teknikat bazë fotografike dhe identifikimin individual të cetaceve, kryesisht delfinë, sipas shenjave të veçanta (ngjyrimeve, nishaneve, vijëzimeve, rrudhave etj) në trup dhe në pendët e notimit. Ndonëse defektet e motorrit të varkës nuk lejuan realizimin e plotë të 45 ditëve të planifikuara për vëzhgimin në det, ekuipazhi bëri rreth 3000 km lëvizje në ujrat detare të Malit të Zi, nga kufiri me Kroacinë dhe Gjiri i Kotorrit në veri deri në grykën e Lumit Buna dhe kufirin me Shqipërinë në jug. Nga 26 ditë udhëtime në det, në 15 prej tyre u vëzhguan delfinë. Numri më i madh i delfinëve u vërejt në det të hapur dhe janë takuar gjithashtu dy grupe thujse të përhershëm delfinësh, njëri përballë fshatit turistik Petrovac (pranë Budvës) dhe tjetri brenda Gjirit të Kotorrit.



Disa breshka detare janë parë gjithashtu gjatë këtij vëzhgimi, si edhe peshq të mëdhenj pelagjikë si toni, skumbri dhe peshku shpatë.

Krahas ekipit të zakonshëm të vëzhgimit, në varkë herë pas here ishin të pranishëm edhe studentë dhe ekspertë të huaj.

Në planet e vitit 2014 përfshihet vazhdimi i këtij vëzhgimi të delfinëve në pranverë dhe verë, favorizuar edhe nga blerja e planifikuar e një motorri të ri për varkën, si dhe përgatitja e data – bazës me të dhenat e foto-identifikimit.

*Zdravko Ikica - Instituti i Biologjisë Detare, Kotorr*

## LAJME SHKURT

### Takimi i radhës i partnerëve të projektit në Chioggia (Itali) – Mars 2014



Takimi i radhës i partnerëve të projektit do të organizohet nga ISPRA dhe do të mbahet në Chioggia (Italy) në Mars 2014. Ky aktivitet do të jetë i dobishëm për partnerët e NETCET në vlerësimin e arritjeve të deritanishme të projektit, si dhe për të planifikuar hapat dhe aktivitetet e ardhëshme, në realizim të objektivave të tij.

## Newsletter 3



The project is co-funded by the European Union,  
Instrument for Pre-Accession Assistance.



## Contact

City of Venice

+39 041 2747826 / 7830 / 7834

European Policies Division

[www.netcet.eu](http://www.netcet.eu)

San Marco 4299  
30124 Venice - Italy

[www.facebook.com/NETCETproject](https://www.facebook.com/NETCETproject)

[info@netcet.eu](mailto:info@netcet.eu)

This Newsletter has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this Newsletter are the sole responsibility of the City of Venice and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authorities.